



Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall këtë:

KONKURS EKSPERT/E I/E ILUSTRIMIT DHE SHENJËZIMIT

Ilustrimi dekorativ, dizajnimi dhe punimi i shenjëzimit informues në hapësirat e brendshme dhe jashtme të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Iliria" në Prishtinë

Kompenzimi: 3000 (Tre mijë Euro Neto)

Periudha: Afati kohor për realizimin e punës është deri në përfundim të punimeve nga NPB, maksimum 120 ditë.

Përshkrim i projektit

Ndërmarrja Publike Banesore ka marr përsipër rregullimin e kushteve infrastrukturore të SHFMU "Iliria", duke përfshirë renovimin e objektit në hapësirën e brendshme dhe të jashtme të shkollës, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve të përshtatshme për vijimin e procesit mësimor për të gjithë nxënësit e shkollës.

Si pjesë e aktiviteteve që parashihen të plotësojnë punën e NPB-së, është edhe konceptualizimi, ilustrimi si dhe shenjëzimi informativ i hapësirave të përbashkëta të shkollës. Rrjedhimisht, NPB është në kërkim të ekspertizës për ilustrimin e pjesëve dekorative, punimin dhe shenjëzimit informues brenda dhe jashtë objektit shkollor.

Qëllimi i projektit

Eksperti/ja duhet të bashkëpunojë ngusht me NPB-në për të krijuar një tematikë të përshtatshme për shkollën në përgjithësi, dhe grupmoshave të nxënësve në veçanti. Format dhe ngjyrat duhet të përzgjedhen për tu përshtatur me pjesën tjetër të enterierit të shkollës, që të krijohet harmoni e gjithmbarshme brenda dhe jashtë objektit shkollor.

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një ambienti mikpritës për nxënësit, si dhe krijimi i një sistemi shenjëzues të thjeshtë e të kuptueshëm për nxënësit, stafin, dhe mysafirët.

Hollësi rreth projektit

Shkolla Fillore, Mesme e Ulët "Iliria" shtrihet në një sipërfaqe prej 15,000.00².

Objekti shkollor ka 4,006.00 m² në 4 etazhe, dhe hapësirë muresh me potencial për ilustrim prej rreth 1,000.00 m².

Ndërmarrja Publike Banesore në bashkëpunim me ekspertin/en do të vendosin në përzgjedhjen e mureve për ilustrim dhe informim. Pavarësisht nga oferta, NPB dhe eksperti/ja

do ta diskutojnë mënyrën e bashkëpunimit dhe organizimit për tu siguruar që puna të përfundojë në afat dhe me cilësi të lartë.

Detyrat:

- a) Eksperti/ja e ilustrimit dhe shenjzimit duhet të bashkëpunojë ngusht me personat përgjegjës të NPB-së si dhe të marr aprovimin nga të njejtit për të krijuar një tematikë të përshtatshme për shkollën në përgjithësi, dhe grupmoshave të nxënësve në veçanti.
- b) Eksperti/ja është përgjegjës/e për gjithë procesin e përpilimit, planifikimit dhe zhvillimit të projektit;
- c) Eksperti/ja është përgjegjës/e për sigurimin e resurseve për implementim të projektit duke mospërfshirë materialet (materialet dhe veglat sigurohen nga NPB)
- d) Eksperti/ja është përgjegjës/e dhe realizimin e plotë të punës sipas afatave kohore të parapara.

Kriteret:

- a) Kualifikimi akademik (preferohet master)
- b) Përvoja praktike në fushën e ilustrimit (preferohet mbi 15 vite)
- c) Përvoja në realizimin e projekteve të mëdha dekoruese e informuese është përparësi.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga ëeb faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesit-punesimi/ . Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. "Zija Shemsiu", nr. 22, Prishtinë, të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- a) Formulari për aplikim i NPB-së;
- b) Dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- c) Portofolio me të paktën 5 punime.

Shpallja është e hapur që nga 12.08.2022–16.08.2022 në ora 16:00

Afati kohor për realizimin e punës është deri në përfundim të punimeve nga NPB.

NPB e kupton hapësirën e ngushtë kohore të këtij projekti, andaj inkurajon aplikimin e personave me përvojë të gjatë, të gatshëm të punojnë edhe jashtë orarit e ditëve të punës.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 606 672.